



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-077
Prishtinë, më 11 tetor 2016

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 11 TETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Në fillim të seancës kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se Kosova duke filluar nga janari i vitit 2017 do të marrë pjesë në seancat parlamentare të Këshillit të Evropës me një delegacion të përbërë nga tre anëtarë: pozitë, opozitë dhe nga pakicat, sepse më 5 shtator të këtij viti Byroja e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës ka marrë vendim me shumicë votash për zbatimin e paragrafit 13 të Rezolutës 2049/2016 për situatën e Kosovës dhe rolin e Këshillit të Evropës, i cili parashikon ngritjen e nivelit të bashkëpunimit të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës me Kuvendin e Kosovës.

Ai i falënderoi nënkryetarët e Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe znj. Aida Dërguti, për punën dhe angazhimin që kanë dhënë në këtë proces.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Blerta Deliu-Kodra, Njomza Emini, Glauk Konjufca, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Qerim Bajrami, Abdyl Ymeri dhe ministri i Arsimit, Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me plan-programet, librat shkollorë në shkollat me mësim në gjuhën serbe në Republikën e Kosovës.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Shukrije Bytyqi i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit gjatë emërimit të stafit politik në Inspektoratin e Arsimit dhe në komisionet e licencimit.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Shukrije Bytyqi.

Deputetja Besa Baftija i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me ndërtimin e një shkolle në komunën e Gjilanit, për shkak të kushteve të rënda në objektin aktual.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Besa Baftija.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me vonesën e shpërndarjes së teksteve shkollore për nxënësit në këtë viti shkollor.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Zafir Berisha i parashtroi pyetje ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, në lidhje me matësit e energjisë elektrike.

Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj deputetit Zafir Berisha.

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skender Hyseni, në lidhje me numrin e punëtorëve të huaj në Kosovë dhe nga cilat shtete janë këta punëtorë.

Ministri Skender Hyseni iu përgjigj deputetit Faton Topalli.

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me numrin e punëtorëve në ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Faton Topalli.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me mundësinë e shtimit të numrit të nënkalimeve ose mbikalimeve në autostradën “Ibrahim Rugova”, konkretisht në regjionin e Prizrenit.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Mytaher Haskuka.

Deputeti Ali Berisha i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me përfundimin e punimeve në ndërtimin e rrugës magjistrale Prishtinë-Pejë.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Ali Berisha.

Deputeti Rexhep Selimi i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skender Hyseni, në lidhje me hetimet për rastet e vjedhjes në dhomat e dëshmive në Policinë e Kosovës.

Ministri Skender Hyseni iu përgjigj deputetit Rexhep Selimi.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi i parashtroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në lidhje me largimin e punëtorëve nga puna në kompaninë KEDS.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrij pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me rezolutat e miratuara të Kuvendit që bien ndesh me ligjet pozitive të Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 29 shtator 2016.

4. Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar. Por, për mungesë të kuorumit, votimi i kësaj pike është shtyrë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	55,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Z. Avdulla Aliu emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore, me mandat njëvjeçar. Mandati i të emëruarit fillon nga data 24 tetor 2016.

5. Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka rishqyrtuar Projektligjin për investimet strategjike në Republikë, së bashku me përmirësimin teknik të amendamentit 32, i cili është miratuar në seancën plenare, e mbajtur më 8 korrik 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentin 32 të përmirësuar nga Komisioni Funkcional.

Kryetari i Komisionit Funkcional, z. Muhamet Mustafa, paraqiti dhe arsyetoi lidhur me propozimin për përmirësimin e amendamentit 32 të Projektligjit për investime strategjike në Republikën e Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për projektligjin e lartshënuar.

Lidhur me Projektligjin për investimet strategjike në Republikën e Kosovës diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, Glauk Konjufca, në emër të GP VV, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër

të GP “Nisma” dhe Duda Balje, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentin nr. 32, të propozuar nga Komisioni Funkcional.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi amendamentin 32 të propozuar nga Komisioni Funkcional.

Më pas, kryesuesi e hodhi për votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	57,
Kundër-----	14,
Abstenime-----	11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Miratohet Ligji për investimet strategjike në Republikën e Kosovës.

6. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar. Por, për mungesë kuorumi nuk është proceduar për votim Propozim-rezoluta e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës për interpelancë.

Kryesuesi e hodhi për votim Propozim-rezolutën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	29,
Kundër-----	37,
Abstenime-----	6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Kuvendi nuk e miratoi rezolutën e propozuar nga deputeti Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 6 (gjashtë) deputetë nënshkrues, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës.

7. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar. Por, për mungesë kuorumi nuk është proceduar për votim Propozim-rezoluta e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës për interpelancë.

Kryesuesi e hodhi për votim propozim-rezolutën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	28,
Kundër-----	35,
Abstenime-----	7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Kuvendi nuk e miratoi rezolutën e propozuar nga deputeti Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 7 (shtatë) deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për akreditim

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Tregtisë dhe Indusstrisë, znj. Hykmete Bajrami, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Fjala e znj. Hykmete Bajrami është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për akreditim diskutuan: në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Muhamet Mustafa, në emër të GP të PDK-së, Hajdar Beqaj, në emër të GP të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të GP të LVV-së, Glauk Konjufca, në emër të GP të AAK-së, Pal Lekaj, në emër të GP “Nisma”, Zafir Berisha dhe në emër të GP të “6+” Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	62,
Kundër-----	1,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

1. Miratohet në parim Projektligji për akreditim.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONal dhe komisionet e përhershme që, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit FunkSIONal, z. Nait Hasani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin propozuar gjithsej 6 amendamente nga Komisioni FunkSIONal.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	60,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	12.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Miratohet Ligji nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

10. Shqyrtimi i raportit mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONal për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Sadri Ferati, në emër të Komisionit FunkSIONal, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për raportin e lartshënuar.

Lidhur me raportin mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015 diskutuan: Agim Aliu, në emër të GP të PDK-së, Sadri Ferati, në emër të GP të LDK-së, Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV-së, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma” dhe Qerim Bajrami, në emër të GP të “6+”, si dhe deputetët: Selviqe Halimi, Veton Berisha, Teuta Haxhiu, Emilia Rexhepi dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, si dhe ministri Mahir Jagxhillar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	33,
Kundër-----	23,
Abstenime-----	7

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Miratohet raporti për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

11. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Sadri Ferati, në emër të Komisionit Funkcional, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për raportin e lartshënuar.

Lidhur me raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015 diskutuan: Hajdar Beqaj, në emër të GP të PDK-së, Muhamet Mustafa, në emër të GP të LDK-së, Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV-së, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, Duda Balje, në emër të GP të “6+”, si dhe deputetët Melihate Termkolli, Teuta Haxhiu dhe Mytaher Haskuka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	29,
Kundër-----	30,
Abstenime-----	3,

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015.

12. Zgjedhja e 1 (një) anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Kryesuesi për mungesë të kuorumit (votim i fshehtë) nuk procedoi zgjedhjen e 1 (një) anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 15:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale